

FATOS KONGOLI  
**VEPRA**

**KUFOMA**  
ROMAN

**3**

---

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

**VEPRA**

1. Ne të tre - *roman*
2. I humburi - *roman*
3. Kufoma - *roman*
4. Dragoi i fildishtë - *roman*
5. Ëndrra e Damokleut - *roman*
6. Lëkura e qenit - *roman*
7. Te porta e Shën Pjetrit - *roman*
8. Jetë në një kuti shkrepësesh - *roman*
9. Në pritje të Nostradamusit - *tregime*
10. Karuseli - *roman*
11. Bolero në vilën e pleqve - *roman*
12. Iluzione në sirtar - *autobiografi*
13. Si-do-re-la - *roman*
14. Njeriu me fat - *roman*
15. Gjemia e mbytur - *roman*
16. Gënjeshtarë të vegjël - *roman*
17. Kapitulli i Amerikës - *autobiografi*
18. Stinë pandemie - *roman*
19. Misteri i mjellmës - *roman*
20. Ballo me maska ose shakaja e fundit - *roman*

FATOS KONGOLI  
VEPRA

# KUFOMA

roman

3

BOTIMET TOENA

*Botim i veçantë në kuadër të Veprës.*

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Arlinda Rrushi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960474

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

# 1.

Më në fund ai u bind se atë natë s'do të vinte gjumë në sy. Ishte përpjekur të humbiste, të çlirohej qoftë për disa çaste nga makthi që i shtrydhte zemrën, dhe ndoshta pa e kuptuar kishte fjetur. Por ndihej i dërrmuar, me përshtypjen se diçka e neveritshme i qarkullonte nëpër trup bashkë me gjakun. Një erë gjirizi e kishte ndjekur kudo, në zyrën e vet, në korridoret e ndërmarrjes, në rrugë, në pijetore, ku kishte pirë një birrë të nxehtë (si e përmjerrë miu), në shtëpi, në të gjitha mjediset e shtëpisë, deri në shtrat, ku s'mbante mend prej sa orësh përpëlitej pranë trupit të së shoqes.

Gruaja po flinte me një mënjanim të lehtë, që i shkaktonte një derdhje të gjinjve anash. Dikur, ky pozicion e trondiste. Kur ajo flinte

kështu, dhe për një arsye apo një tjetër atij i dilte gjumi, rrëshqiste pranë saj, i ngacmonte themthat, ia thithte, derisa edhe asaj i dilte gjumi. Tani një orvatje e tillë do të dështonte. Në rastin e reagimit më të butë, e shoqja do të lëshonte një hungërimë pakënaqësie dhe do t'i kthente shpinën. Po qe se ai s'bindej me kaq, mund të ndodhte të hante ndonjë të sharë përgjumshëm, e nëse edhe e shara nuk do të kryente ndonjë efekt, ajo mund të shoqërohej me një të shtyrë. Këto do të ishin rastet e mundshme nëse ai do të orvatej të kujtonte “monë e shkuar”, sido që ishte vetëm dyzet vjeç, kurse ajo vetëm tridhjetë e pesë, pra brenda lojës së trilleve të natës. Por ai nuk pati ngacmime të kësaj natyre. Jo nga frika e ndonjë reagimi të pakëndshëm të së shoqes. As ngaqë i erdhi keq ta zgjonte. Nën ndriçimin e hënës, trupi lakuriq i gruas dukej si një statujë mermeri dhe me gjithë makthin që i shtrydhte zemrën ai nuk e pati në dorë të mos binte pre e dyshimit të vjetër: e tradhtonte vallë ajo? Burri mbyti përbrenda një psherëtimë, duke i përpirë lakoret e buta të trupit të së shoqes milimetër për milimetër, nga qafa në sup, nga supi në brinjë, nga brinja në lartësinë e legenit, deri poshtë, përgjatë rrëzimit të kofshëve.

Në këto e sipër ai ndjeu në vete një ngacmim më konkret dhe më urgjent se dhimbja e një tradhtie të supozuar bashkëshortore. U rrotullua ngadalë, doli nga shtrati dhe në

gjysmëterr zuri të kërkonte pantoflat. WC-ja ishte allaturka, gryka qe zënë me një tapë të madhe prej gome qysh kur, para ca vjetësh, një mi qe ngjitur nëpërmjet tubacionit të ujërave të zeza nga kanali nëntokësor deri në katin e katërt. Kishte qenë një mi i madh, i zi, i llahtarshëm. Kështu qe shprehur e shoqja atë natë tek kthehej nga banja pas një britme të lemerishme: “Në apartamentin tonë ka hyrë një mi i madh, i zi, i llahtarshëm”. Në të vërtetë ai s’kishte parë gjë, as mi, as ndonjë qenie të ngjashme me miun. Kishte parë vetëm fytyrën e zbardhur të së shoqes, britma e së cilës, falë qetësisë së mesnatës, duhej të ishte dëgjuar larg. Me një shufër hekuri, që e përdornin për të shkundur blözën e qyngjeve të sobës, ai kishte kërkuar në të gjitha qoshtet e apartamentit, në çdo skutë që mund të shërbente si strehë për kafshën, por miun nuk ia kishin zënë sytë. Kjo qe bërë shkak që për disa ditë me radhë gruaja të përjetonte një krizë nervash, derisa arritën në përfundimin se enigma e zhdukjes së miut shpjegohej me faktin që ky i fundit, i trembur nga britma e gruas, duhej të qe kthyer mbrapsht, domethënë duhej të qe larguar andej nga qe futur, nëpërmjet kanalit të banjës. Që nga ajo kohë ata e mbyllnin grykën e kanalit me tapën e trashë prej gome, të cilën burri e kishte porositur në një repart gomisterie të nesërmen e ngjarjes.

Sidoqoftë, mendoj ai tek hiqte tapën për të urinuar, historia e miut duhet të ketë qenë

një shpikje e fantazisë, e shoqja nuk mund të rrinte pa sajuar ngjarje ngacmuese. Por mbase, kundërshtoi aty për aty vetveten, ajo ka parë vërtet një mi. Ndoshta të madh, të zi e të llahtarshëm. Dhe e përshkoi një drithmë. Tek derdhte urinën, nga gryka e kanalit të banjës u ngrit një erë e rëndë, era e zakonshme që çlirohet netëve të nxehta në WC-të allaturka. I tmerruar ai e përjetoi me intensitet dërrmues ndjesinë se ishte mi, se sapo kishte dalë nga gryka e kanalit dhe era e qelbur çlirohej nga trupi i tij. As që bëhej fjalë të kthehej në shtratin bashkëshortor. E shoqja, me gjithë vapën mbytëse, flinte mbështjellë në avujt e djersës. Kutërbimi i tij rrezik ta zgjonte. Nën terrorin e makthit, në majë të gishtërinjve, burri doli nga banja. Në kuzhinë ndodhej një divan. Një copë herë u përpëlit duke vështruar hënën e plotë që varej tej dritares. Atij iu duk se ajo nuk ishte Hëna, sateliti i vetëm i Tokës. Iu duk se ishte një llambadar kinez, i verdhë gjer në verbim. Pastaj humbi në një gjumë të thellë.

## 2.

Unë isha larguar para tre muajsh, në një zbor tremujor. Dhe isha i sigurt se ndërkaq, në kuptimin absolut të fjalës, asgjë nuk kishte ndryshuar. Apartamenti ku banoja, dhomë e kuzhinë, vazhdonte të ndodhej atje ku e kisha lënë, në lagjen Nr. 9 të kryeqytetit, në katin e katërt të një pallati ku verës uji ngjitej vetëm një herë në ditë, nga ora tre e mëngjesit deri aty rreth orës pesë, ndërsa dimrit tri herë, pa kohëzgjatje të rregullt, në mëngjes, në drekë e në darkë. Në shtëpi më prisnin gruaja, djali dhe pjesa ime e punëve shtëpiake.

Edhe qendra ime e punës, pa dyshim, nuk kishte lëvizur nga vendi. Ishte një shtëpi botuese, më e madhja e kryeqytetit, grosiste, siç e quanin. Godina e saj e zymtë shtatëkatëshe, me mure tullash të

kuqe, e pasuvatuar, ngrihej buzë rrugës automobilistike, përballë një rajoni policie, në atë udhëkryqin e famshëm të Tiranës, të pagëzuar me datën “21 Dhjetori”, që për brezat e rinj nuk kishte ndonjë kuptim, përderisa pak prej tyre mund ta dinin se ishte ditëlindja e një njeriu të quajtur Stalin. Përkundrazi, nuk qenë të paktë ata që më bënë të ditur se duhej të ndihesha fatlum që kisha nderin të kapërceja sa herë të doja derën e asaj godine ku përgatiteshin kartëvizitat e personaliteteve të larta zyrtare. Unë s’kisha të bëja as me sektorin e kartëvizitave, as me atë të botimit të portreteve. I përkisja një kategorie punonjësish të përmasave modeste, merresha me tekstet e librave të ilustruar për fëmijë.

Shumëkush, sa herë paraqitej rasti, nuk ngurronte të më kujtonte edhe diçka, që duhej të ishte për mua një tjetër arsye për të qenë i lumtur. Por këtë kapitull s’qe nevoja të ma kujtonin. Jo rastësisht i përkisja një kategorie punonjësish të përmasave modeste: tekstet për fëmijë dhe kartëvizitat e personaliteteve zyrtare ishin, siç thuhet, hane Shan, hane Bagdat. Meqë ra fjala, katin përdhes të godinës pjesërisht e zinte administrata, pjesërisht një bufe-restorant. Shkalla më e ulët e rëndësisë së punonjësve ishte në katin e parë. Unë punoja në këtë kat. Në përgjithësi, kushdo që ia sillte puna të kishte të bënte

me ne, për të parë se sa na vlente lëkura, na pyeste se në ç'kat punonim, pyetje që për një pjesë të kolegëve të rangut tim tingëllonte fyese dhe provokuese. Unë nuk fyhesha, aq më pak priresha të merrja për provokator një njeri që do të më drejtonte një pyetje të tillë. Pretendimet e mia për peshë shoqërore prej kohësh nuk shkonin përtej katit të parë të asaj godine. Më sipër ngjitesha rrallë, zakonisht me urdhër nga lart, domethënë me urdhër të eprorit të katit tim, të eprorëve të kateve të tjera dhe, edhe më rrallë, tepër rrallë, me urdhër të eprorit të eprorëve, drejtorit të përgjithshëm. Zyra e tij ndodhej në katin e shtatë, kati i gjithëpushtetshëm i kartëvizitave të personaliteteve të larta zyrtare. Përveç punonjësve të këtij kati, atje nuk futej njeri. Urdhurat, kundëruddhurat, udhëzimet, kundërudhëzimet, ceremonitë, dekorimet, pushimet nga puna, lavdërimet, ndëshkimet e të tjera veprimtari të kësaj natyre kryheshin në katin përdhes. Sipas rastit, në sallën e madhe të administratës, kur ishin të karakterit serioz, ose në lokalin e bufe-restorantit kur ishin të karakterit më pak serioz, për shembull, mbrëmjet kolektive të dëfrimit.

Gjatë tre muajve të largimit tim në zbor asgjë nga këto nuk kishte ndryshuar. Zyra ime vazhdonte të ndodhej atje, në fund të

korridorit. Në të vërtetë ajo nuk ishte zyrë. Ishte një dhomë relativisht e madhe, po e quaj zyrë-studio, ku punonin një piktor e një piktore të seksionit të ilustrimeve për fëmijë. Më kishin caktuar aty përkohësisht dy vjet më parë. Sepse unë isha pranuar të punoja në tempullin e botimeve vetëm dy vjet më parë, pas një odiseje bredhesh andej-këndej. Në atë kohë kati ishte i mbipopulluar, nuk u gjend vend i lirë nëpër zyrat e tjera, kështu që mbeti si i përshtatshëm varianti i vendosjes sime në zyrën-studio me premtimin që, me t'u paraqitur rasti, do të kaloja në një zyrë të mirëfilltë, rast që nuk u paraqit ndonjëherë, sepse kati mbetej vazhdimisht i mbipopulluar.

Në fillim unë nuk e kuptova shqetësimin që u shfaq në fytyrën e eprorit të katit kur ai po përpiquej të më mbushte mendjen se vendosja ime në zyrën-studio bëhej, siç u shpreh, vetëm përkohësisht. Këtë kuptova kur shefja e administratës, një grua elegante, me flokë që herë i mbante të mbledhura topuz e herë i lëshonte, me shoqëroi në fund të korridorit. Ishte verë dhe, sa më shumë shtyheshin drejt fundit, aq më ngulmuese bëhej një erë e dyshimtë, derisa i rashë në të se nuk ishte gjë tjetër veçse erë WC-sh.

WC-të, një për meshkuj e një për femra, gjendeshin pikërisht përballë zyrës-studio ku do të punoja unë. Dyert mbi të cilat qenë ngjitur simbolet dalluese përkatëse ishin të mbyllura. Dera e zyrës-studio, përkundrazi,

ishte e hapur e kjo më dha të kuptoja se kolegët e mi të rinj, me sa dukej, qenë mësuar me erën e WC-ve. Gjatë kohës që shefja e administratës më paraqiti tek ata, unë i mbaja sytë poshtë, ja ngase nuk dija ku t'i çoja, ja ngase nuk i përballoja dot vështrimet e tyre: më kishin mbërthyer, siç m'u duk, në një mënyrë jo fort miqësore. E vërteta që krejt ndryshe. Sytë e mi ishin qepur pa vetëdije te këmbët e shifes së administratës, aty përpara meje. Sikur ato këmbë të mos mbuloheshin nga një shtresë qimesh, do të mund të quheshin të shkëlqyera. Dhe mjafton t'i çoje sytë ca më lart, te vithet, që të përftyroje se ajo në krevat duhej të ishte një partnere vështirë e përballueshme.

I denë se shefja e administratës si partnere shtrati duhej të ishte serioze e kisha formuar para disa ditësh, në zyrën e saj, në katin përdhes, ku ajo më kishte thirrur për të më njoftuar emërimin zyrtar. Me gjithë emocionet e rastit, të përlijtura në rrethanat e mia, unë s'kisha mundur të mos e shihja bashkëbiseduesen me sytë e mashkullit. Ndoshta ngaqë në vend të një shefeje administrate klasike, domethënë një shëmtire as mashkull, as femër, në atë zyrë që kundërmonte parfum gjeta një femër rreth të tridhjetave, me ca sy ku e pata të vështirë të lexoja simpati apo mospërfillje. Nuk e pata të

vështirë të vija re diçka tjetër: fustani veror i qe varur ca si tepër përpara e për këtë arsye pjesa e sipërme e gjinjve i mbetej e zbuluar. Ishte shkujdesje apo pozicion i llogaritur, nuk mund ta them. S'bëra as përpjekjen më të vogël për të mos i çuar sytë atje. Ajo e ndjeu vështrimin tim, për këtë s'pata pikë dyshimi. Qenia e saj çlironte diçka agresive e për një çast u hutova, sidomos kur gruaja foli, formuloi urimin e rastit me një zë pa ngjyrë, që gjithashtu s'kuptohej në shprehte simpati apo mospërfillje. Kjo zgjati derisa gruaja, me një lëvizje të kontrolluar, zhduku çdo keqkuptim midis gjinjve të saj dhe syve të mi, duke krijuar kështu një keqkuptim real: ç'marrëdhënie do të krijoheshin midis nesh?

Këtë pyetje i përsërisja vetes tek shihja nga mbrapa këmbët e shefes së administratës. Mbase qe hamendje, por unë kisha formuar bindjen se midis meje dhe asaj gruaje, deri para disa ditësh e panjohur, ishte vendosur një marrëdhënie. Mendimet e mia ngatërroheshin kur përpiqesha të sqaroja natyrën e kësaj marrëdhënieje. Pa dyshim ajo më njihte. Si shefe administrate, në mos gjithçka, ajo duhej të dinte shumëçka rreth meje dhe qëndrimi i saj mund të interpretohej në mënyra të ndryshme. Mund të interpretohej si ftesë për miqësi, por edhe si paralajmërim. Këtë nuk e përcaktoja dot. Sepse nuk isha në gjendje të përcaktoja ku fillonte tek ajo femra e ku shefja

e administratës. Në këtë kuptim unë s'mund t'i lejoja vetes shkujdesje. Çdo shkujdesje do të ishte për mua e pafalshme.

Sapo vija nga vuajtja e një dënimi, miqtë e mi më këshillonin që tash e tutje t'i bëja sytë katër. Miqtë e mi të paktë më këshillonin të mos shkelja më në dërrasë të kalbur, siç kisha shkelur, duke rrezikuar të humbisja gjithçka. Tani që golgothaja ime mund të quhej e kapërcyer, duhej të ndihesha i kënaqur që kisha shpëtuar me kaq. Pas kësaj golgothaje kati i parë i tempullit të botimeve ishte për mua një mrekulli e papritur, po të mendoje se, eventualisht, mund të ndodhesha në atë që quhet "shtëpi pa qira". Shefja e administratës duhej ta dinte që, tre vjet më parë, aq sa zgjati golgothaja ime, kisha shpëtuar për qime nga shtëpia pa qira. Dhe unë nuk kisha ndonjë arsye që të mos mbaja parasysh se këtu ajo paguhej si shefe administrate, jo si femër me gjinj magnetikë. Me ç'pashë, kolegët e rinj këtë të vërtetë e mbanin parasysh. Gjatë kohës së shkurtër që ajo më paraqiti, ata qëndruan në këmbë. Kur po largohej, ajo buzëqeshi. Buzëqeshën edhe kolegët e mi të rinj. Unë i kisha çuar sytë përsëri, me vetëdije ose jo, te këmbët e saj.

Të nesërmen e kapërceva derën e armatosur me shufra hekuri të tempullit si një njeri që e kapërcen atë prag prej vitesh,

dhe kur u ndodha përballë shkallëve nuk u kujtova se këto të çonin në zyrën e shefes. Nuk u kujtova për të as kur u ndodha në korridorin e gjatë të katit të parë, ndoshta sepse papritur më doli një problem: në të dy anët, nga kreu në fund, për shkak të vapës, dyert e zyrave ishin të hapura dhe mua do të më duhej të kaloja si në revistë nderi tërë garniturën redaktoriale. Po ndoshta nuk u kujtova për të, sepse, ndryshe nga kolegët e rinj, nuk po mësohesha dot me erën e WC-ve. Ta mbaje derën e zyrës mbyllur plasje vape, ta lije hapur duhej të përballoje aromat e jashtëqitjeve të të dy seksëve që popullonin katin, ku, siç mund të përfytyrohet, mbizotëronte era therëse e urinës femërore. Në këto kushte gjendja ime e nervozuar ishte e përligjur.

Nja dhjetë minuta si kisha zënë vend në tryezën e punës, në cep të dhomës, pranë dritares, prej nga dukej rruga automobilistike dhe një peizazh mediokër, pa e duruar dot kutërbimin e WC-ve, këputa diçka të përafërt me shprehjen e mëposhtme: “Erë kaq e qelbur nuk besoj se vjen as në haletë e bushmenëve”. Një shprehje e tillë, e thënë qoftë dhe me zë të ulët, ishte njëlloj sikur të ankoheshe në një vend publik, në prani të personave të dytë apo të tretë, për mungesën e mishit, për radhën e gjatë në dyqanin e qumështit, për gatimin e keq të bukës, e

më the e të thashë. Reagimi i kolegëve qe i ndryshëm. Piktorja, një grua e mbajtur, rreth të dyzetave, me një lëkurë të lëmuar e me ca flokë gështenjë, nuk e ngriti kokën, duke lënë kështu të mendoje se ajo nuk kishte dëgjuar gjë. Tjetri, përkundrazi, nuk e fshehu kënaqësinë që i kishte shkaktuar deklarata ime. Qe një burrë shtatmesatar, i zeshkët, me flokë të rënë, të cilit vështirë t'ia përcaktoje moshën. Buzëqeshja e tij dëshmonte së paku se nuk vuante nga mungesa e ndjenjës së humorit. Gjithsesi, u pendova për krahasimin me haletë e bushmenëve. Një kallëpi si unë, me qimen e derrit, nuk i lejoheshin batuta të tilla. Për t'i hedhur pak ujë verës, vura në dukje se e gjithë puna ishte të pajiseshin WC-të me dyer që mbylleshin hermetikisht. Më pas thashë diçka për nevojën e ujit të rrjedhshëm për t'i shkarkuar banjat – theksova banjat, jo haletë – nga ekskrementet njerëzore. Së fundi, shtova një vërejtje për pastrueset: me sa dukej ato nuk e kryenin detyrën.

Në reagimin e kolegëve nuk pati ndonjë zhvillim të ri. Gruaja, me kokën ulur, la të kuptohej se ato që thoja ishin gjëja e fundit që i interesonte, kurse burri më përcolli me të njëjtën buzëqeshje. Atëherë më erdhi të ngrihesha, ta kapja për fyti atë burrec që ngërdheshej, ta zija për flokësh atë derdimene që shtirej sikur s'dëgjonte. Dhe mendova se

duhej të isha një mëkatar i mjerë përderisa providenca e shihte me vend të më dënonte deri në këtë pikë, domethënë të ndaja zyrën me bagëti si kolegët e rinj.

Burrin e quanin August. Shkurt e thërrisnin Gusti. Gruan e quanin Kleanthi. Shkurt e thërrisnin Klea. Ndryshe nga Klea, Gusti shfaqti një prirje miqësore ndaj meje. Kjo u materializua kur në limontinë e atyre ditëve ai më mësoi një mënyrë zbavitjeje origjinale. Për të zbavitja ishte rutinore, për mua një zbulim. Falë pozicionit të zyrës-studio, pata rastin të shihja se seksi i dobët formonte shumicën dërrmuese të popullsisë së katit. Këtë e vura re duke vëzhguar me Gustin frekuentimin e WC-ve: femra, vetëm femra e më të rrallë ndonjë mashkull. Në përgjithësi ato nuk i shqetësonte fakti se WC-ja ndodhej përballë një dhome ku dera rrinte e hapur vazhdimisht, pra mund të vëzhgoheshin prej andej nga sy kureshtarë. Ardhja ime nuk solli ndonjë ndryshim në sjelljen e tyre. Kisha dëgjuar të flitej për dendësi të seksit të dobët në tempullin e botimeve, por ashtu si Gusti u binda se përdorimi i këtij termi, domethënë “seks i dobët”, në rastin e dhënë ishte pa vend.

Në një nga ato ditë u kujtova për shefen e administratës. Që ajo, si të gjitha qeniet e gjalla, duhej të kryente nevoja fiziologjike,

nuk diskutohej. Po ku i kryente? Gusti, ndoshta, si specialist në këtë lëndë, duhej të dinte diçka. Nuk e trazova. Do të ishte e padrejtë të trazoja Gustin e pafajshëm për një problem kaq delikat. Edhe po të ishte në gjendje të më jepte përgjigje, domethënë të më tregonte se ku i kryente nevojat fiziologjike shefja e administratës, ne nuk kishim aq afërsi sa të mbërrinim deri këtu. Veç të tjerash, zgjidhja e problemit nuk mund të sillte ndonjë element të ri në sqarimin e dilemës se ç'marrëdhënie do të vendoseshin midis meje dhe shefes së administratës. Ky sqarim do të vinte papritur, në një mënyrë disi të sëkëlldisur.

Ndodhi kur autorit të shquar të vjershave për fëmijë K. K. i hipi të vinte të grindej me Gustin pikërisht një ditë, kur ky kishte hedhur disa gota dhe rrinte ulur në tryezën e tij të punës përballë dyerve të WC-ve, me një humor që mund të quhet agresiv. K. K. qe një barkmadh sa, po të ulte kokën, rrezik se nuk shihte as seksin e vet. Një copë herë ata shkëmbyen batuta me zë të ulët, dhe në largësinë ku ndodhesha s'dëgjoja përse bëhej fjalë. Ca nga ca gjakrat u ndezën. Me ç'dukej poeti i shquar e akuzonte Gustin që ky me dashakeqësi i zvarriste ilustrimin e një libri. Gusti mbrohej duke thënë se ai ndiqte një sira për ilustrimin e librave, se siranë e caktonte tjetërkush dhe askush nuk mund ta prishte. Këmbimi i batutave

degjeneroi kur poeti i shquar, për të cilin unë vërtet dyshova në ishte në gjendje të shihte nga pozicioni gatitu seksin e vet, e ngriti zërin, goditi tryezën me grusht dhe, duke përmbysur dy kuti me bojëra guash, i deklaroi Gustit se ishte një piktor i dështuar. Fytyra e zeshkët e Gustit mori ngjyrën e tullës së pjekur. Tërhoqi njërin nga sirtarët e tryezës, nxori prej andej diçka që u pa se ishte dorëshkrim dhe ia tundi përpara turinjve. “Këto porkerira, i tha duke treguar nga WC-të, vlejnë për atë zyrën atje. Jo për prapanicën time, unë nuk denjoj të fshij as prapanicën me porkerirat e tua. Madje ato nuk bëjnë as për prapanicat e bushmenëve. E di ti, poetuc, ç’janë bushmenët?”

K. K. u zbraps nja dy-tri hapa, si ta kishin goditur me tullë kokës. Pastaj mërmëriti nëpër dhëmbë: “Ta tregoj unë ty prapanicën e bushmenëve, maskara”. Dhe iku. Gushti e shoqëroi me një “vafsh në të sat’ëme”, që, sipas çdo gjase, duhej të qe dëgjuar nga ikanaku. Fytyra e bardhë e Kleas, e cila kishte ndjekur duelin e burrave me shastisjen e zakonshme, kishte marrë ngjyrën e shkumësit. Dhe propozimi që Gustit t’i dilja në mbrojtje unë erdhi prej saj. Sipas Kleas, veremliu K. K. do të shkonte të ankohej te shefja e administratës. Nëse kjo nuk do të ndodhej në humor të mirë, këtë radhë Gustit mund t’i kushtonte shtrenjtë: dy javë më parë ai ishte paralajmëruar për pushim nga puna për një